


KËRKESË ANKIMORE

Drejtuar: Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS)
në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Adresa: Rruga "Ibrahim Rugova", Ndërtesa nr. 4: Tiranë



ora: 20:25

ANKUESI	
Subjekti Ankues	Adresa, posta elektronike dhe/ose nr. i telefonit Tel: 0697839115 / 0682077094
KOALICIONI "BASHKË FITOJMË" - BF	

<u>OBJEKTI I ANKIMIT</u>	
<p>1. Kundërshtimi i Vendimit Nr. 85, datë 05.08.2024 - KZAZ Nr. 88 - "Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë HIMARË", në zgjedhjet e pjesshme të datës 04.08.2024 ;</p> <p>2. Pavlefshmëria e zgjedhjeve të zhvilluara në të gjitha Qendrat e Votimit (gjithsej 36 QV-të) e zonës zgjedhore Bashkia Himarë ;</p> <p>3. Rregullimin e pasojave duke shpallur pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në të zonës zgjedhore Bashkia Himarë.</p>	
Vendimi	<u>TITULLI I VENDIMIT</u> <u>"Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Himarë"</u>
Nr.	Datë
85	05.08.2024
<p>1. Miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Himarë, bashkelidhur këtij vendimi me 3 faqe ;</p> <p>2. Shpalljen fitues për Kryetar të Bashkisë Himarë, z. Vangjel Llambi TAVO, propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë..</p>	
<p>Baza Ligjore: Nenet: 3, 8, 21, pika 1, gërma "a", neni 26 pika 2, neni 39, pika 2, nenet 115, 116, 117, 118, 119, 122, 123/2, 124, 126, 133,136,138,141, 143,160 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar</p>	

NË LIDHJE ME PROCEDURËN DHE KONTESTIMIN

A. Në lidhje me legjitimitimin e palës ankuese



Neni 122 i Kodit Zgjedhor parashikon se nxjerrja e tabelës përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve për Bashkitë me 1 KZAZ, behet nga KZAZ-ja, menjëherë pas përfundimit të numërimit, sipas procedurave të përcaktuara në nenet 116 deri në 119 të Kodit Zgjedhor.

Tabela Përmbledhëse e Rezultateve të Zgjedhjeve të ZAZ-së miratohet me vendim të KZAZ-së. Një kopje e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve dhe tabelave të rezultateve për çdo qendër votimi, dërgohet menjëherë në KQZ, përfshirë edhe rrugët elektronike të komunikimit.

Referuar Nenit 123/1 të Kodit Zgjedhor, parashikohet e drejta për të vënë në lëvizje KQZ-ne, si një e drejte që i njihet subjekteve zgjedhore, në mbrojtje të interesave të tyre të ligjshme dhe për çështje që bëjnë pjesë në rrethin e kompetencave të KQZ-së.

Sipas pikes 2 të këtij Neni, kërkesat ose ankesat e subjekteve zgjedhore trajtohen sipas procedurës së përcaktuar nga ky ligj dhe nga aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Kërkesat, ankesat, informacionet, propozimet apo denoncimet e palëve të treta trajtohen sipas procedurës së përcaktuar në Kodin e Procedurave Administrative dhe sipas afateve që përcakton KQZ-ja me akt nënligjor.

Ndërsa, neni 124, pika 2 parashikon se çdo parti politike, pjesëtare ose jo e një koalicioni, ka të drejtë të ankohet në KQZ kundër vendimeve të KZAZ-së që çënojnë interesat e tyre të ligjshëm, brenda 5 ditëve nga data e shpalljes së vendimit:


“2. Kundër vendimit të KZAZ-së për shpalljen e rezultatit për zgjedhjet e organeve të njësisë të qeverisjes vendore nën juridiksionin e saj, të marrë sipas nenit 122 të këtij Kodi, mund të paraqitet ankimi në KQZ jo më vonë se 5 ditë nga shpallja e vendimit për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore. Ankimi ndaj vendimit mund të përmbajë ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore ose/dhe pavlefshmërinë e rezultatit në një apo disa qendra votimi, sipas nenit 160 të këtij Kodi”.

- Zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë u caktuan në datën 4 Gusht 2024, me dekretin e Presidentit të Republikës.

- Me Vendimin nr. 112, datë 23.07.2024, KQZ regjistroi subjektin zgjedhor “Partia Demokratike”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024” ;

- Me Vendimin nr. 124, datë 25.07.2024 KQZ regjistroi Koalicionin “Bashkë Fitojmë”, të kryesuar nga Partia Demokratike, për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datë 4 gusht 2024.

Siç e cituam edhe në krye të herës, duke qene një Bashki me vetem 1 KZAZ, rezultatet e zgjedhjeve të Bashkisë Himarë të datës 4 Gusht 2024, miratohen në nivel KZAZ-je; Kështu, në datë 05.08.2024, në ora 18.00 KZAZ nr. 88 ka miratuar tabelën përmbledhëse të rezultateve, duke shpallur fitues kandidatin z. Tavo të propozuar nga subjekti Partia Socialiste e Shqipërisë, me 5022 vota kundrejt kandidatit z. Gjukuria i propozuar nga subjekti Koalicioni Bashkë Fitojmë (BF) me 3545 vota.



BF e konteston këto table përmbledhëse rezultatesh për shkaqet dhe arsyet që do të paraqesim në vijim.

Duke qene se jemi subjekt zgjedhor i regjistruar rregullisht ne zgjedhjet e Bashkise Himare, si dhe duke qene se ankimi jone paraqitet brenda afatit 5-ditor nga momenti i shpalljes se tabelës permbledhese te rezultateve nga KZAZ, gjujkojme se kemi legjitimitet per shqyrtimin e kerkeses tone ankimore perpara KAS.

B. Në lidhje me kompetencën e organit administrativ

Neni 12, pika 5e Kodit Zgjedhor parashikon se Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve (në vijim KAS) është organi kompetent për shqyrtimin e ankimeve administrative. Neni 21, pika 1, gërma “a” parashikon se KAS-i vendos për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në një ose më shumë zona zgjedhore apo në të gjithë vendin, si dhe përsëritjen e pjesshme ose të plotë të zgjedhjeve. Ndërsa, neni 123, pika 5, 124 e vijues të Kodit Zgjedhor parashikon se vendimet për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit Zgjedhor ankimohen në KAS.

Me Vendimin objekt ankimi është vendosur miratimi i Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për kandidatët për kryetar Bashkia Himarë nga KZAZ nr. 88. Në zbatim të Kodit Zgjedhor, çdo subjekt zgjedhor ka të drejtë të paraqesë ankim kundër vendimit për miratimin e tabelave përmbledhëse të rezultatit zgjedhor, brenda afatit ligjor.

Në këtë kuptim, Koalicioni “BF” përmbush kriterin e dytë procedural, kompetencën lëndore, për shqyrtimin e këtij ankimi.

C. Në lidhje me afatin e paraqitjes së ankimit

Kriteri i tretë për paraqitjen e një ankimi administrativ kundër vendimit për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit Zgjedhor ka të bëjë me afatin ligjor të ankimit. Për këtë, neni 124, pika 2 ka parashikuar shprehimisht që kundër vendimit të KZAZ për miratimin e Tabelës Përmbledhës të Rezultatit për kandidatët për Kryetar Bashkie, mund të bëhet jo më vonë se 5 ditë nga shpallja e këtij vendimi.

Në rastin konkret, vendimi objekt ankimi është shpallur në datën 05.08.2024. Ankimi është paraqitur brenda afatit 5-ditor të parashikuar nga dispozitat perkatese të Kodit Zgjedhor. Në këtë kuptim, Koalicioni “BF” përmbush kriterin e tretë procedural, afatin ligjor, për paraqitjen e këtij ankimi.

Konkluzion: Neni 130 i Kodit Zgjedhor përcakton se KQZ merr vendim për pranimin e kërkesës ankimore, pasi verifikon: a) kompetencën e KQZ-së; b) legjitimitimin e ankuesit; dhe c) respektimin e afateve ligjore. Duke qenë se sic kemi shpjeguar më lart, ankimi i paraqitur nga BF përmbush të tre kriteret proceduriale (*legjitimitimin, kompetencën dhe afatin ligjor*), kërkojmë nga Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve kalimin për shqyrtim të kërkesës ankimore te paraqitur nga Koalicioni “BF” lidhur me zgjedhjet në Himarë.

PËRSHKRIMI I SHKELJES SË PRETENDUAR

Në mbështetje të Dekretit nr. 13864, datë 24.10.2022, të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”, u zhvilluan zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Pas përfundimit të procesit të numërimit të votave në Bashkinë Himarë, KZAZ-ja Nr. 88 me vendimin Nr. 85 datë 05.08.2024, miratoi tabelat përmbledhëse të rezultateve për kandidatët për Kryetar Bashkie të



Bashkisë Himarë, duke shpallur fitues kandidatin e PS z. Tavo duke fituar 5,022 vota (ose 58.6%), ndërkohë që Kandidati i mbështetur nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë” z. Petraq Gjiguria mori 3,545 vota (ose 41.4%).

Koalicioni Bashkë Fitojmë, ka ardhur në dijeni të fakteve, indicieve dhe ka siguruar prova të mjaftueshme lidhur me problematika dhe parregullsi të rënda të procesit zgjedhor të ndodhura në të gjitha Qëndrat e Votimit (36-QV) të Bashkisë Himarë.

Zgjedhjet e Pjeshme për Kryetarin e Bashkisë Himarë të 4 gushtit 2024 u mbajtën në një klimë politike të ngarkuar, ndërkohë që opozita në vijimësi e akuzon mazhorancën qeverisëse dhe eksponentë të saj për pengim të votuesve (rasti i kartave të identitetit të skaduara), përdorim të administratës në zgjedhje, zbkarkimin e gjysmës së ministrave në ditët e fundit të fushatës dhe të zgjedhjeve në Himarë, pa lene menjane intimidimet ndaj votuesve, bizneseve, pronareve të hoteleve, të cilët ishin në pikun e sezonit turistik gjatë fushatës dhe ditëve të zgjedhjeve.

Por, mbi të gjitha, problemi më i madh në zgjedhjet e 4 gushtit në Himarë ishte pamundësia e votimit për zgjedhësit që kishin dokumente identifikimi të skaduara dhe ky numër votuesish që u penguan të votonin, ndryshe nga 1 vit më parë, ishte në mbi 6000 votues në Bashkinë e Himarës, ku në total rezultoi se në 4 gusht votuan rreth 8500 zgjedhës.

Ditën e zgjedhjeve, u bë publike një problematikë e ditur edhe më parë nga vetë KQZ-ja, që lidhej një numër shumë të lartë zgjedhësish, të cilët nuk dispononin në ditën e zgjedhjeve një dokument identifikimi të vlefshëm, pasi u kishte kaluar afati i përdorimit.

Në vijim, po analizojmë të faktet, argumentat dhe dispozitat ligjore ku mbështetet ankimi.

FAKTET, ARGUMENTAT, DISPOZITAT LIGJORE KU MBËSHTETET ANKIMI.

Referuar Nenit 160 “Pavlefshmëria e zgjedhjeve në qendrën e votimit” parashikon se:

“1. KQZ-ja, kryesisht ose me kërkesë të subjekteve zgjedhore, i shpall zgjedhjet të pavlefshme në një apo më shumë qendra votimi, në rast se:

a) kanë ndodhur shkelje të ligjit, të cilat kanë cenuar rëndë procesin zgjedhor ose kur tërësia e shkeljeve të ligjit, sipas kësaj shkronje, të ndodhura në ato qendra votimi mund të ketë cenuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore;

b) kanë ndodhur fatkeqësi natyrore në përmasa të tilla, që kanë penguar pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim; ose

c) votimi nuk ka filluar apo është pezulluar për më shumë se pesë orë.

2. Subjektet zgjedhore, në përputhje me rregullat dhe afatin e përcaktuar në nenin 124 të këtij Kodi, kanë të drejtë të kërkojnë në KQZ shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në qendra të caktuara votimi.

3. Kërkesa për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve duhet të përmbajë shkaqet ligjore përshkrimin e rasteve të shkeljeve dhe arsyetimin e detajuar për pasojën e tyre.

4. Shqyrtimi i kërkesave bëhet sipas procedurave të përcaktuara në pjesën X të këtij Kodi. KQZ-ja, në marrjen e vendimit për pavlefshmërinë e zgjedhjeve, mund konsultohet me KZAZ-në përkatëse. Në arsyetimin e vendimit të KQZ-së duhet të përshkruhet shkaku ligjor, rastet e vërtetuara të shkeljeve dhe arsyetimi i detajuar për pasojën e tyre”.

Të gjitha faktet, indicjet dhe provat në disponimin tonë, provojnë në mënyrë të qartë dhe të pakundërshtueshme se kemi të bëjmë me shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor :

Zgjedhjet e Pjeshme për Kryetarin e Bashkisë Himarë të 4 gushtit 2024 u mbajtën në një klimë politike të ngarkuar, ndërkohë që opozita në vijimësi e akuzon mazhorancën qeverisëse dhe eksponentë të saj për korrupsion të thelluar dhe lidhje me krimin e organizuar.



Një problem madhor në zgjedhjet e 4 gushtit ishte pamundësimi i votimit për zgjedhësit që kishin dokumente identifikimi të skaduar.

Ditën e zgjedhjeve, u bë publike një problematikë e ditur edhe më parë nga vetë KQZ-ja, që lidhej një numër shumë të lartë zgjedhësish (mbi 6.000 zgjedhes), të cilët nuk dispononin në ditën e zgjedhjeve një dokument identifikimi të vlefshëm, pasi u kishte kaluar afati i përdorimit. Kjo problematikë ishte ngritur para zgjedhjeve nga anetaret e Komisionit Rregullator pranë KQZ. Kjo problematikë ishte prezente edhe në zgjedhjet e vitit të shkuar në Maj 2023, kur në atë kohë, për të zgjidhur këtë shqetësim, Këshilli i Ministrave kishte miratuar zgjatjen e periudhës së vlefshmerisë së kartave ID të skaduar, me qëllim mundësimin e votimit të atyre personave kartat ID e të cilëve kishin skaduar dhe nuk kishin patur mundësi fizike që t'i rinovonin.


Në kushtet kur kjo problematikë ishte e ditur nga vete KQZ, por edhe nga Këshilli i Ministrave, si dhe në kushtet kur në Bashkinë Himare ishin mbi 6.000 votues në listat e zgjedhësve kartat ID të të cilëve kishin skaduar (nga rreth 23.000 zgjedhes në total), atëherë, në këto kushte, mosmarrja e masave të duhura nga ana e këtyre institucioneve shtetërore, cenon të drejtën kushtetuese të të drejtës për të zgjedhur dhe shkel parimet themelore të barazisë para ligjit.

Këto të drejta themelore të njeriut të garantuara edhe nga Kushtetuta e Shqipërisë, nuk mund të cenoheshin apo të asgjësoheshin me akte administrative të cilitdo organ shtetëror, përfshirë KQZ. Këto janë shkelje teper të rënda, që cenojnë standardet me minimale të një gare të barabartë dhe të ndershme, si dhe cenojnë sigurinë juridike dhe barazinë. Në Himarë ka patur mjaft raste ku i njëjti qytetar, në vitin 2023 pati mundësi të votonte me kartë ID të skaduar, (për efekt të vendimit të Këshillit të Ministrave), ndërsa këto here në gusht të 2024 i'u mohua e drejta për të votuar, për shkak se nuk u moren të njëjtat masa si vitin e shkuar nga ana e institucioneve shtetërore).

Ndërkohë që në raste të mëparshme zgjedhore, votimi i personave me dokumente identifikimi të skaduar ishte bërë i mundur me anë të një akti normativ të qeverisë shqiptare, në Zgjedhjet e 4 gushtit asnjë hap i tillë nuk u ndërмор. As në mënyrë proaktive nga vetë Këshilli i Ministrave, e as nga KQZ-ja dhe partitë politike për të institucionalizuar menjëherë me shpalljen e datës së zgjedhjeve, rrugëzgjidhjen e kësaj problematike.

Në këto rast gjejmë me vend të theksojmë edhe njëherë, se vlefshmeria apo jo e dokumentit të identifikimit si koncept përdoret për menaxhimin burokratik të shërbimeve shtetërore, por vlefshmeria e dokumentit ID që përmbajnë të dhëna UNIKE dhe biometrike, të ruajtura në sistemet shtetërore, nuk mund të vihen në diskutim për të IDENTIFIKUAR se mbajtësi i atij dokumenti është personi në fjalë. Prezantimi i një dokumenti ID ditën e zgjedhjeve, shërben pikërisht për të identifikuar tej çdo dyshimi se X person që paraqitet për të votuar në QV, është pikërisht personi i cili e identifikon veten me atë dokument dhe ai dokument me fotografi, numer unik personal të pandryshueshëm, dhe të dhëna të tjera biometrike unike, shërben pikërisht për të identifikuar cili është personi që paraqitet në QV për të votuar. Skandanca e "kartonit" të ID, pra e letërnjoftimit, nuk ben të "pavlefshme" të dhenat e sakte të personit që e mban atë, të pakten për të kryer funksionin minimal të IDENTIFIKIMIT se kush është ai person. Nëse do të ishte e kundërta, atëherë zgjatja e vlefshmerisë së kartave ID në të shkuarën do të kishte qenë pa paligjshme.

E drejta kushtetuese e së drejtës së votës prevalon ndaj çdo teknikaliteti të gjetur si arsye për të mos ndërmarrë miratimin e aktit nga Qeveria për zgjatjen e vlefshmërisë së këtyre kartave. Për më tepër që për më shumë se 3 palë zgjedhësish kjo masë lehtësuese për qytetarët ishte bërë një praktikë pozitive që ndërmerrej me vullnet të mirë prej institucioneve shtetërore, bazuar pikërisht tek detyrimi dhe parimet kushtetuese, duke krijuar kështu pritshmeri të ligjshme tek këta zgjedhes se kjo masë do të ishte e zbatueshme edhe kesaj here. Në këto kushte, jemi përpara cenimit të asaj që quhet Siguria Juridike, që është një tjetër parim i konsoliduar i të drejtës.



Po ashtu, Partia Socialiste në pushtet përdori burimet shtetërore dhe të tjera privilegje që vijnë nga të qenit në pushtet për avantazh elektoral edhe përgjatë kësaj fushate në Himare. Në mënyrë të veçantë, kandidati i PS z. Tavo, i cili ishte perflitej prej kohësh në mënyrë jo formale se do të ishte kandidati i kësaj partie për Kryetar të Bashkisë Himarë, u emërua Prefekt i Qarkut Vlorë në mars 2024, pra vetem 4 muaj përpara zgjedhjeve.

Në këtë mënyrë, ndërkohë që zhvillonte takime elektorale të parakohshme si kandidat për kryetar bashkie, z. Tavo ishte edhe Prefekt i Qarkut të Vlorës, zone e cila perfshin edhe Bashkinë Himare, cka jo vetem perben "konflikt interesi", por sa kohe Prefekti si rregull monitoron dhe kontrollon ligjshmerine e akteve te organeve te pushtetit vendor, por perben shkelje te hapur te Kodit Zgjedhor per sa i perket mos perdorimit te administrates per qellime elektorale. Z. Tavo duhej te ishte dorehequr nga detyra e Prefektit ne momentin qe ai vendosi te kandidonte si kryetar Bashkie ne nje bashki qe ai kishte kompetence funksionale t'a kontrollonte si Prefekt Qarku. Duke vepruar ndryshe, z. Tavo ka cenuar barazine ne gare duke perdorur postin shteteror per qellime elektorale.

Sipas vrotuesve te pavarur te zgjedhjeve, por edhe mediave, përgjatë fushatës zgjedhore, kandidati i Partisë Socialiste përfitoi gjithashtu edhe nga mbështetja e zyrtarëve të ndryshëm publikë, përfshirë këtu edhe zv. Kryeministren, znj. Belinda Balluku, Ministria e Turizmit, znj. Mirela Kumbaro dhe Kryetarin e Bashkisë Vlorë, z. Ermal Dredha.

Një nga tematikat kryesore të fushatës së kandidatit të Partisë Socialiste, z. Tavo, ishte zgjidhja e **problemeve të pronësisë**, nje problem ky i rende ne bashkine e Himares. Në këtë çështje dukshem pati një koordinim të qartë mes institucioneve shtetërore dhe fushatës së kandidatit Tavo, duke e avantazhuar atë në garën elektorale.

Konkretisht, përgjatë muajve maj dhe qershor 2024, Kryeministri Rama shpërndau çertifikata pronësie për banorët e bashkisë Himarë, duke i përdorur këto evente institucionale për të bërë fushatë të parakohshme për z. Tavo, i cili e shoqëronte Ramën në këto takime.

Për më tepër, në së paku njërin prej këtyre eventeve ishte i pranishëm, edhe Drejtuesit Politik i kësaj partie për Qarkun Vlorë, z. Blendi Klosi, (i cili aktualisht nuk mban asnjë pozicion institucional shtetëror), duke u dhënë këtyre aktiviteteve nota qartazi politike e partiake.


Nese i rikthehemi problematikes se listes se zgjedhesve, në listën e zgjedhësve në Himare ishin 23,074 zgjedhës, nga të cilët 385 ishin zgjedhës për herë të parë.

Lista e Zgjedhësve u gjenerua nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC) brenda afateve ligjore por **Listat e zgjedhësve nuk u afishuan as në ambientet me akses të lirë për publikun në Bashki dhe as në ambientet e Qendrave të Votimit, në kundërshtim me ligjin. Ditën e zgjedhjeve, listat e zgjedhësve ishin të afishuara në disa qendra votimi, por jo në të gjitha.**

Në datën 15 korrik 2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve miratoi emërimin e auditit teknikien dhe ndihmësit të tij, që do të verifikonte integritetin e listave të zgjedhësve. **Raporti i tij ngre shqetësime madhore në lidhje me lëvizje potenciale të zgjedhësve për qëllime elektorale përgjatë periudhës parazgjedhore.**

Sipas audituesit, në listën përfundimtare të zgjedhësve, në Bashkinë Himarë ishin shtuar 311 zgjedhës të cilët kishin ndryshuar vendbanimin mes zgjedhjeve të vitit 2023 dhe 2024. Data e lëvizjes së këtyre zgjedhësve është e paqartë, por prirja është tejet e dyshimtë, duke qenë se dukshëm lëvizjet janë bërë mes dy proceseve zgjedhore. Shumica e zgjedhësve që kanë ndryshuar vendbanimin janë nga bashkitë Tiranë dhe Vlorë (90 dhe 68 respektivisht).

Një tjetër problematikë e vërejtur nga auditit teknikien është prania në listën e zgjedhësve e 157 zgjedhësve nga i njëjti trung familjar që votojnë në qendra të ndryshme votimi, ndryshe nga sa parashikohet në raste të tilla nga Kodi Zgjedhor.



Referuar të dhënave të transferimeve, sipas dokumentit që DPGJC i ka dërguar KQZ-së, ajo çka bie në sy është se, ndërkohë që shumica e ndryshimeve të gjendjes civile janë me numra të vegjël dhe të shpërndarë në një kohë thuhet një vjeçare, vetëm në katër ditë pune, mes shpalljes së datës së zgjedhjeve (5 korrik) dhe ditës kur është gjeneruar lista e zgjedhësve (10 korrik), janë regjistruar 30% e transferimeve totale; 93 zgjedhës nga 311 në total që kanë ndryshuar vendbanimin pas 14 majit 2023.

Në një intervistë televizive të datës 31 korrik 2024, z. Tavo pranoi se disa nga personat e denoncuar në SPAK që kanë ndryshuar vendbanimin janë familjarë të vet, ndërkohë që ka pretenduar se nuk kishte patur dijeni për këtë apo të tjerë persona që kanë ndryshuar vendbanimin.

Edhe nga provat dhe faktet e tjera që do të paraqiten deri në seancën në KAS, do të provohet se ka patur një numër të lartë personash të cilët u është mohuar e drejta e votës, nepermjet zhvendosjes së votuesve pas shpalljes së zgjedhjeve nga Presidenti, nepermjet pengimit të votuesve me karta të skaduara, nepermjet vonesës së rinovimit të kartave të atyre votuesve të cilët nuk ishin identifikuar si votues të PS nga patronazhimi, dhe në të kundërt, nepermjet pershpejtimit të marrjes së rinovimit të kartave ID për ata votues të cilët mund të kete qene votues të listuar si prane PS nga procesi i patronazhimit. Ekzistojnë mjaft raste kur persona të caktuar që kanë rinovuar kartat pak dite para ditës së zgjedhjeve, pajisja PEI nuk ja njihet vlefshmerine e kartës, dhe këta persona kanë votuar duke hedhur të dhenat manualisht.

Perdorimi i patronazhisteve nga Mazhhoranca dhe PS, vazhdon edhe në këto zgjedhje të ishte një problem serioz, i denoncuar jo vetëm nga Opozita, dhe mediat, por edhe nga organizatat dhe vezhguesit e zgjedhjeve. Rezulton se ka patur pretendime të besueshme për përdorim të administratës në fushatën zgjedhore dhe organizime nga ana e mazhorancës dhe PS **në drejtimin e votës në mënyrë kapilare [Patronazhimi]**, nëpërmjet nepermjet orientimit dhe shoqerimit deri pranë qendres së votimit të individëve, çka u manifestua edhe në ditën e zgjedhjeve nga grupimet e personave që tentonin të drejtonin votën në mënyrë të organizuar në afërsi të qendrave të votimit në të 36 QV e Himares.

Edhe në këto zgjedhje, sikurse edhe në zgjedhjet e mëparshme, vërehet si tejet shqetësuese prania e personave të paautorizuar në afërsi të qendrave të votimit. Prania e këtyre personave në afërsi të qendrave të votimit është i kundërligjshëm dhe ndikon qartas vullnetin e votuesve; **Zgjedhësit mund të ndihen të intimiduar për të marrë pjesë apo për të votuar lirish në kushte të tilla të të qenit vazhdimisht të kontrolluar dhe në survejim.** Raportohet se në një numër të konsiderueshëm rastesh, personat e paautorizuar që qëndronin pranë qendrave të votimit ose ishin të pajisur me lista, kjo u mundësonte të kishin informacion të plotë mbi personat që paraqiteshin për të votuar.

Për të përforcuar këto qëndrime të Koalicioni ankues, në interesin më të lartë të procesit zgjedhor që ka të bëjë me rezultatin e zgjedhjeve të kësaj Bashkie, kemi administruar disa nga tabelat përmbledhëse dhe kerkojme administrimin nga KQZ [marrjen si prove nga KAS] e librit të protokollit të mbledhjeve të KZAZ-se si dhe cdo dokument tjetër shkresor apo elektronik, që diponohet nga KQZ lidhur me Pajisjet PEI në të 36 QV e Bashkisë Himare, numrin e personave të cilët nuk kishin ID apo Pasaporta të vlefshme, numrin e personave të cilët u është refuzuar e drejta për të votuar për shkak të një dokumenti ID apo Pasaporte të vlefshëm, si dhe numrin e personave të cilët kishin karta të rinovuara ditë e fundit dhe nuk ishin njohur nga pajisja PEI, por rezultojnë të shenuar manualisht në sistem.

Nga këto dokumente do të konstatohet se nga përmbajtja e vendimmarrjeve të KZAZ-se rezultojnë e shenuar në proces-verbal moslejimi i votimit të mbi personave me dokumenta identifikimi të vlefshëm, duke bërë që kjo shkelje të ketë cenuar procesin e votimit, të kësaj zone zgjedhore, në një masë të tillë, sa diferenca prej rreth 1400 vota do të vihej në pikepyetje, pra duke cenuar procesin në një masë të tillë sa të passillte pavlefshmerine e rezultatit dhe si pasoje, do të sillte perseritjen e zgjedhjeve.

Në përputhje me parashikimet e nenit 136, pika 3 të Kodit Zgjedhor, ku parashikohet shprehimisht se: "Kërkesa për marrjen e provave, sipas shkronjës "c" të pikës 1 të këtij neni, kur mbështetet nga dy anëtarë të KQZ-së dhe kur këto prova administrohen vetëm nga KQZ-ja, pranohet menjëherë pa iu nënshtruar debatit ose votimit në KQZ. Në këtë rast organi shqyrtues i Ankimit, pra KAS është i detyruar të procedojë

menjëherë me marrjen dhe shqyrtimin e provave të kërkuara”, dhe në përputhje me parashikimet e nenit 138 ”Këqyrja e materialit zgjedhor” të Kodit Zgjedhor, KAS me vendim të ndërmjetëm duhet të vendosi të kryejë administrimin e plote e të gjitha provave shkresore që gjenden në KQZ apo KZAZ për t’i dhënë zgjidhje shteruese objektit të ankimit.

- Për sa i përket këtyre shkeljeve,

Në vlerësimin tonë ka prova të mjaftueshme për të disponuar sipas objektit të kërimit.

Sa më sipër kërkojmë:

1. Kundërshtimi i Vendimit Nr. 85, datë 05.08.2024 - KZAZ Nr. 88 - “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë HIMARË”, në zgjedhjet e pjesshme të datës 04.08.2024 ;
2. Pavlefshmëria e zgjedhjeve të zhvilluara në të gjitha Qendrat e Votimit (gjithsej 36 QV-të) e zonës zgjedhore Bashkia Himarë ;
3. Rregullimin e pasojave duke shpallur pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në të zonës zgjedhore Bashkia Himarë.

**PROVAT QË PARAQITEN
DHE /OSE KËRKOHEN, BURIMIN SI DHE NUMRI I TYRE.**

1. Vendimi Nr. 85 i KZAZ nr. 88 ;
2. Kopje të dokumentave të tjera.

**Përfaqësuesi Ligjor i Koalicionit
“BASHKË FITOJMË”**

z. Franci NURI

Franci NURI

Tiranë, 09/08/2024

Nr. i kopjeve: 3 (tre)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KZAZ nr:	88
Qarku	Vlorë

VENDIM	
Nr:	85
Datë:	05.08.2024
Ora:	18:00

PËR MIRATIMIN E TABELËS PËRMBLEDHËSE TË REZULTATEVE PËR
ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË BASHKISË HIMARË.
(për bashkitë teritori i të cilave mbulohet nga një ZAZ)

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor Nr. 88, Qarku Vlore, në mbledhjen e tij të datës
05.08.2023, shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve të Zonës së
Administrimit Zgjedhor Nr. 88, Qarku Vlorë për zgjedhjen e
kryetarit të bashkisë Himarë, në zgjedhjet e datës 04.08.2024.

BAZALIGJORE: Neni 33, pika "ë" dhe "g", 122, pika 3, i Ligjit nr.10019, datë
29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor, pasi shqyrtoi hap pas hapi procesin e nxjerrjes së
rezultateve për 36 QV, pasqyro rezultetet e të dhënave respektive për çdo QV mbi bazën e tabelave
origjinale të rezultateve të grupeve të numërimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjet për kryetar të bashkisë Himarë,
bashkalidhur këtij Vendimi, me 3 faqe dhe të shpallë fitues

Z. VANGJEL LLAMBI TAVO propozuar nga PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË
(emri i partisë, koalicionit ose kandidat i propozuar nga zgjedhësit)



QARKU Vlorë
KZAZ NR 88

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KOMISIONI QENDRORE I ZGJEDHJEVE
TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE
Për kandidatët për kryetar të Bashkisë Himarë



	QV nr 4560/00	QV nr 4561/00	QV nr 4562/00	QV nr 4562/01	QV nr 4563/00	QV nr 4563/01	QV nr 4563/02	QV nr 4565/00	QV nr 4565/01	QV nr 4566/00	QV nr 4566/01	QV nr 4566/00	QV nr 4566/01	QV nr 4566/00	QV nr 4566/01	QV nr 4566/00	QV nr 4566/01	QV nr 4566/00
1 QV-të që pasqyrohen në këtë tabelë	255	200	161	120	304	207	233	185	202	229	287	334	139	268	248	210	106	
2 Numri Zgjedhësve që kanë votuar	112	86	69	58	144	89	107	80	85	115	126	158	82	98	114	95	51	
3 Fletë votimi të papërpunura	540	224	443	455	396	494	450	543	483	405	370	691	318	360	250	430	271	
4 Fletë votimi të demtuara	5	0	0	2	1	0	12	0	0	0	1	0	0	0	2	0	0	
5 Fletë votimi të gjetura në kuti	255	200	161	120	303	207	233	166	202	229	287	334	138	268	248	210	106	
6 Vota të pavlefshme	2	5	1	3	7	2	1	2	4	2	4	2	0	2	4	7	2	0
7 Vota të vlefshme	253	195	160	117	296	205	232	165	200	225	285	334	138	264	241	208	106	

SHPERNDARJA E VOTAVE TË VLEFISHME

Nr	Kandidatët për Kryetar (emri, afërsisht, mbasem)	QV nr 4560/00	QV nr 4561/00	QV nr 4562/00	QV nr 4562/01	QV nr 4563/00	QV nr 4563/01	QV nr 4563/02	QV nr 4565/00	QV nr 4565/01	QV nr 4566/00	QV nr 4566/01	QV nr 4566/00	QV nr 4566/01	QV nr 4566/00	QV nr 4566/01	QV nr 4566/00	QV nr 4566/01
1	Vangel Umrbi Tavo	96	157	78	82	149	127	110	104	139	188	246	269	95	139	174	118	83
2	Petra Gjokaj	157	38	82	35	147	78	122	81	61	37	38	65	41	65	67	90	23
	Gjithsej vota të vlefshme:	253	195	160	117	296	205	232	165	200	225	285	334	138	264	241	208	106

Kryetar
Emri: M. Sullu

Zënkësues
Emri: B. B. B.

Anëtar
Emri: B. B. B.

Anëtar
Emri: M. B. B.

Anëtar
Emri: M. B. B.

Anëtar
Emri: M. B. B.

Anëtar
Emri: M. B. B.



ZGJEDHJE PËR KRYETAR BASHKIE 04 GUSHTI 2009

Modeli KZAZ/0023 (modifikuar me vendimin e Komisionit nr 2 datë 12.04.2012)



QARKU VIORË
KZAZ NR 88

REPUBLIKA E SHqipëRISE
KOMISIONI QENDOR I ZGJEDHJEVE
TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE
Për kandidatët për kryetar të Bashkisë Himarë

Nr	Kandidatët për Kryetar (emri, mbiemri, mbiemri)	QV nr	QV nr	Total	Total me fjalë
1	QV-ja që pasqyrohen në këtë tabelë	4589/00	4600/00	8592	Tërnjësja Qshmeqendme dhe Qshmeqendme
2	Niveli zgjedhësve që kanë votuar gjithsej	155	160	4012	Katërmijëdhjetëdhjetë
3	Fletë votimi të papërdorura	70	70	14877	Katërmijëdhjetëdhjetë e tetë mijë e shtatëdhjetë e shtatë
4	Fletë votimi të gabuara	163	169	31	Tribëdhjetë
5	Fletë votimi të gjetura në kuti	0	0	8591	Tërnjësja Qshmeqendme dhe Qshmeqendme
6	Vota të përvetshme	155	160	124	Njëqind e katër
7	Vota të vlefshme	5	1	8597	Tërnjësja Qshmeqendme dhe Qshmeqendme

SHPERNDARJA E VOTAVE TE VLEFSHME

Nr	Kandidatët për Kryetar (emri, mbiemri, mbiemri)	QV nr	QV nr	Total	Total me fjalë
1	Vangjel Llambi Tavo	4589/00	4600/00	5022	Pesë mijë e dy
2	Petraq Epaminonda Gjokura	127	148	3945	Tremijëdhjetë e katër mijë e pesë
	Gjithsej vota të vlefshme	23	11	5567	Tërnjësja Qshmeqendme dhe Qshmeqendme

Kryetar
Mehmet Sul

Zënkryetar
Gjergj Gashi

Anëtar
Bekim Hyseni

Anëtar
Vedat Kallmeti

Anëtar
Bashkim Hyseni

Anëtar
Gjergj Hyseni

Anëtar
Donat Bello





QARKU VIORË
KZAZ NR 88

REPUBLIKA E SHqipëRISE
KOMISIONI QENDOR I ZGJEJHJEVE
TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE
Për kandidatët për kryetar të Bashkisë Himarë



Nr	Kandidat për Kryetar (emri, arasia, mbiemri)	QV nr	QV nr	QV nr	Totali	Totali me fjalë
1	QV-ia që pasqyrohen në këtë tabelë	4599/100	4800/100		9399	Të gjithë QV shtetërisht të regjistruar
2	Nivni Zgjedhëse që kanë votuar	155	160		315	Katëmbëdhjetë mijë e pesëdhjetë e nëntë
3	Fleta votimi të papërdorura	70	70		140	Katëmbëdhjetë mijë e tetëdhjetë e shtatë
4	Fleta votimi të dembluara	163	169		332	Trembëdhjetë mijë e tetëdhjetë e shtatë
5	Fleta votimi të gjetura në kull	0	0		0	Asnjë
6	Fleta votimi të paverifikuara	155	160		315	Trembëdhjetë mijë e tetëdhjetë e nëntë
7	Vota të vlefshme	5	1		6	Sheshdhjetë
		150	159		309	Trembëdhjetë mijë e nëntëdhjetë e shtatë

SHPERNDARJA E VOTAVE TË VLEFESHME

Nr	Kandidat për Kryetar (emri, arasia, mbiemri)	QV nr	QV nr	Totali	Totali me fjalë
1	Vangjel Lleshi Tavo	127	148	275	Qyqind e shtatëdhjetë e katër
2	Petar Epimonda Gjirina	23	11	34	Trembëdhjetë e katër
	Gjithsej vota të vlefshme	150	159	309	Trembëdhjetë mijë e nëntëdhjetë e shtatë

Kryetar
Maksim Suli

Zërvendës
Gjergj Gjeçaj


Anëtar
Bekim Mykëli

Anëtar
Mehmet Kallmeti

Anëtar
Blendi Kallmeti

Anëtar
Elvis Kallmeti

Anëtar
Adriano Bello



2. Tabelat origjinale të rezultatit të çdo QV-je, të plotësuara nga GN-të, janë pjesë integrale e këtij vendimi dhe së bashku me Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve, të dërgohen menjëherë në KQZ.

KAESHQIPËRI
NDORR I ZGJIE
BLEDHËSE
Për kryetar

nr	Emër Mbiemër	Pozicioni	Pro/kundër	Firma
1	Marin Suli	Kryetar	Pro	
2	Jana Bejta	Zv/ Kryetar	Pro	
3	Roland Belevi	Anëtar	Pro	
4	Modest Bekedriua	Anëtar	Pro	
5	Shimshi Koka	Anëtar	Pro	
6	Elmira Balla	Anëtar	Pro	
7	Donald Bello	Anëtar	Pro	

nr	QV
1/01	4563
7	23
3	10
4	4
7	2
5	

MENDIMI PAKICËS

- Unë _____, jam kundër këtij vendimi për arsye se
Kerky te verifikohen identitete e votuesve
te skanuar ne Paj por ne kane
mborur deri me faq identifikim
- Unë _____, jam kundër këtij vendimi për arsye se
Proces i cili ko te bëj me dokumentel
e identifikim me afat vlefshmerie
Marin Suli
- Unë _____, jam kundër këtij vendimi për arsye se



